



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 11, Datë 09.09.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN “NDËRTIMI I FABRIKËS SË PASURIMIT TË KROMIT”, ME VENDNDODHJE NË SURROJ, BASHKIA KUKËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin “Ndërtimi i Fabrikës së Pasurimit të Kromit”, me vendndodhje në Surroj, Bashkia Kukës, me subjekt kërkues shoqërinë konçensionare “Vllaznimi Deda Import-Export” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave.
3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE EKKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



DAMIAN GJKNURI

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT